



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 17.07.2025

Numër Protokolli: 4852/2025

A.nr.845/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtare, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës A.nr.845/2025 të datës 07.05.2025, të parashtruar nga grupi i ankuesve në përbërje prej 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) zyrtarëve të punësuar në Komunën e Gjakovës, ankesë e cila është e regjistruar në emër të ankuesit Z.Sh, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Avokat Esat Sylja, nga Komuna e Skenderajt, kundër organit të punësimit/Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike “*Kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 17.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.845/2025 e datës 07.05.2025, e parashtruar nga ankuesit: Z.Sh, A.N, E.P, B.N, A.A, D.B, N.M, H.B, D.H, M.G, F.Gj, G.S, F.B, B.B, F.S, A.H, M.S, Sh.C, F.Z, G.Q-N, E.H, T.M, V.Sh, Q.B-H, L.Sh, A.P, B.Sh, Zh.G, M.L, K.Ll, D.Th, F.K, V.Rr, Y.B, N.H, B.S, R.D, M.M, Z.L, L.H, D.V, D.K, S.S, R.H, D.L-E, N.M, H.A, D.R, N.Sh, A.B, M. L, A.J, B.E, F.H, S.D, B.V, A.Be, E.B, B.H, B.Sh, L.K, Xh.H, V.Sh, A.D, V.Q, A.H, P.F, V. Ll, P.M, L.V, D.Rr, K.D-Rr, S.V, V.D, D.S, B.Sh-Sh, P.K, L.S, Sh.M, V., A.S, T.B, B.F, K.V, Xh.H, D.G, F.D, A.B, M.R, J.D, H.M, A.E-R, Q.I, L.N, D.K, Q.M, L.I, B.K, B.G, B.Q-D, D.K-O, J.G-V, R.M, D.Th, I.K, J.O, M.D, T.L-U, V.R, B.M, B.D, D.S, G.I, N.Gj, R.H, D.I, A.Sh-D, F.M, P.K, B.M, R.M, D.T dhe B.A, I.M, H.J, N.L, M.M, B.Sh, A.U, S.K, M.M dhe L.H.

II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.01-120/02-17033 i datës 03.04.2025, i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **Shpallet jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.845/2025 të datës 07.05.2025, të parashtruar nga ankuesit: V. Sh dhe V.A.

IV. Lënda e ankuesve sipas pikën **III** të dispozitivit të këtij vendimi bie në kompetencë dhe i dërgohet për shqyrtim Komisionit për Ankesa në Komunën e Gjakovës.

A r s y e t i m

Ankuesit si në pikën I dhe III të dispozitivit të këtij vendimi, të punësuar në Komunën e Gjakovës, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar Avokat Esat Syla, më datë 02.05.2025 përmes postës kanë parashtruar ankesë, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar me datë 07.05.2025 dhe numër protokolli:3054, kundër Vendimit të datës 03.04.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.05.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjakovës, ndërsa Këshilli më datë 26.05.2025 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Kryetari i Këshillit, me datë 19.06.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:4184/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjë A.nr.845/2025 të datës 07.05.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 3054/2025 të datës 07.05.2025 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 03.04.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës; Vendimin e datës 09.09.2015 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin e datës 01.10.2024 të Kuvendit Komunal të Komunës së Shtërpçës; Vendimin e datës 13.12.2024 të Kuvendit Komunal të Komunës së Prishtinës; Zarf postar i datës 02.05.2025 me shifër R6563121; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 20.05.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 20.06.2025; Vendimin e datës 09.09.2015 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; E-mailin e datës 03.04.2025 dërguar nga Komuna e Gjakovës për përfaqësuesin e palëve; Akt Emërimet e ankuesve dhe kontratat e punës për secilin veç e veç, Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:4184/2025.

Kolegji i Këshillit, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës nga palët në këtë procedurë administrative, ka konstatuar se ankesa e ankuesit e datës 07.05.2025, sipas **pikës I të dispozitivit të këtij vendimi** është e **pabazuar**, sepse:

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, konstatoi se ankuesit si në **pikën I** të dispozitivit të këtij vendimi janë të punësuar në kuadër të Komunës së Gjakovës, dhe se të njëjtit sipas Akt Emërimeve kanë statusin e nëpunësit të shërbimit civil, ndërsa të njëjtit me datë 27.03.2025 përmes përfaqësuesit të autorizuar kanë parashtruar kërkesë tek organi i punësimit për kompensim material.

Përmes kërkesës së parashtruar tek organi i punësimit të ankuesit kërkojnë që tu paguhen shujtat në vlerën e 4 euro për ditët e pranisë në punë nga viti 2022 e tutje, duke iu referuar Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me shifër Nr.048/48 të datës 09.09.2015, kompensimin në vlerën prej 0.5% për vitet e përvojës së punës nga hyrja e në fuqi e Ligjit Nr.08/L196 për Pagat në Sektorin Publik, sipas Aktgjykimit KO79/23 të datës 23.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, si dhe kërkojnë kompensimin e shtesave SHCK në pagë në vlerën prej 31.20 euro/muaj për secilin ankues sikurse i kanë realizuar para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L196 për Pagat në Sektorin Publik.

Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Gjakovës përmes Vendimit Nr.01-120/02-17033 të datës 03.04.2025, e ka refuzuar kërkesën e ankuesve të datës 27.03.2023 për kompensim material, me arsyetimin se sipas nenit 44 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L196 për Pagat në Sektorin Publik përcaktohet se: *“Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t’u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji.”*, ndërlidhur me nenin 13, 14 të të njëjtit ligj që rregullon çështjet si në vijim: *“13. Paga e nëpunës/it civilë përbëhet nga paga bazë, shtesat dhe kompensimet, kur shtesat dhe kompensimet janë të aplikueshme sipas këtij ligji; 14.1. Paga bazë e nëpunës/it civil është paga që përfiton nëpunësja/i civil për punën e kryer në një pozitë të caktuar apo për një klasë të caktuar dhe korrespondon me punën e kryer brenda orarit të plotë të punës gjatë një (1) muaji, 14.2. Paga bazë e nëpunës/it civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës e përcaktuar në shtojcën Nr. 10 të këtij ligji, dhe 14.3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik”, dhe nenit 22 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “22. Për orët e punës së kryer, zyrtarja/i publik ka të drejtën e pagës. Paga e zyrtares/it publik rregullohet me Ligjin përkatës për Pagat në Sektorin Publik”.*

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendojnë se u takon e drejta për realizimin e shtesave në vlerën e 4 euro për ditët e pranisë në punë nga viti 2021 e tutje, duke iu referuar vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me shifër Nr.08/48 të datës 09.09.2015, kompensimin në vlerën prej 0.5% për vitet e përvojës së punës nga hyrja e në fuqi e Ligjit Nr.08/L196 për Pagat në Sektorin Publik, sipas Aktgjykimit KO79/23 të datës 23.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, si dhe kërkojnë kompensimin e shtesave SHSCK në pagë në vlerën prej 31.20 euro/muaj për secilin ankues sikurse i kanë realizuar para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L196 për Pagat në Sektorin Publik, më kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e tyre ndërsa të detyroi organin e punësimit të kompensoi shtesat e kërkuara.

Kolegji i Këshillit në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe me rastin e vendimmarrjes mori për bazë dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, në fuqi nga data 05.02.2023, me theks të veçantë: Nenin 1 [Qëllimi] ku përcaktohet se: *1. Qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë, Nenin 2 [Fushëveprimi] paragrafi 1 dhe 3 ku përcaktohet se: 1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, përjashtimisht Agjencisë Kosovare për Inteligjencë. 3. Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për aq sa nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë”, Nenin 45 paragrafi 2, përcakton: 2. Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t’u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji.*

Kolegji i Këshillit, thekson faktin e pakontestueshëm se Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, është shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së tij me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe më datë 23.01.2024, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka publikuar Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, i cili ka hyrë në fuqi më datë 01.02.2024. Përmes këtij aktgjykimi, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, ka shpallë të pavlefshëm paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 dhe paragrafin 2 të nenit 45 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat

në Sektorin Publikë, ndërsa ka detyruar Kuvendin e Republikës së Kosovës që brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e këtij aktgjykimi të ndryshojë dhe plotësoj paragrafin 2 të nenit 2 dhe paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë.

Kolegji i Këshillit, në ndërlidhje me shqyrtimin e çështjeve të ngritura nga palët, konstaton faktin se është fakt i pakontestueshëm që Gjykata Kushtetues e Republikës së Kosovës, përmes aktgjykimit të cekur si më lartë ka shpallur të pavlefshëm paragrafin 2 të nenit 45 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, mirëpo përmes këtij Aktgjykimi, në **IV. Efektet e Aktgjykimit** ka sqaruar dhe përcaktuar çështjen e efekteve juridike të këtij aktgjykimi në raport ligjin e kontestuar dhe dispozitivit të aktgjykimit, ashtu që me pikën 377 të këtij aktgjykimi, specifikon se: *Gjykata ka konstatuar se paragrafi 2 i nenit 2 (Fushëveprimi) dhe paragrafi 2 i nenit 45 (Shfuqizimi), në ndërlidhje me paragrafin 2 të nenit 24 (Shtesa për kushte të tregut të punës), paragrafi 5 i nenit 25 (Shtesa e performancës) dhe paragrafi 4 i nenit 28 (Shtesa për vëllimin e punës) dhe paragrafët 2 dhe 3 të nenit 42 (Përcaktimi i ekuivalencës) të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me Kushtetutën për sa i përket pavarësisë funksionale, organizative dhe buxhetore të institucioneve të pavarura kushtetuese, me theks në institucionet e përcaktuara përmes Kapitullit VII [Sistemi i Drejtësisë], Kapitullit VIII [Gjykata Kushtetuese] dhe Kapitullit XII [Institucionet e Pavarura]. Sipas sqarimeve të dhëna në këtë Aktgjykim, (i) paragrafi 2 i nenit 2 të Ligjit të kontestuar ua pamundëson institucioneve të pavarura kushtetuese që në përmbushje të pavarësisë së tyre kushtetuese të funksionojnë edhe me ligje të veçanta dhe e kufizon pavarësinë e tyre funksionale, organizative dhe buxhetore vetëm në nxjerrjen e akteve nënligjore në rrethanat e përcaktuara specifikisht sipas Ligjit të kontestuar; (ii) paragrafi 2 i nenit 45 të Ligjit të kontestuar shfuqizon çdo dispozitë të ligjit dhe akt nënligjor që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorive tjera në fushën e pagave, përfshirë të gjitha dispozitat e ligjeve të veçanta që ndërlidhen me institucionet e pavarura kushtetuese dhe aktet e tyre nënligjore; dhe (iii) paragrafët 2 dhe 3 të nenit 42 të Ligjit të kontestuar të lexuar së bashku me paragrafin 2 të nenit 2 të tij, i detyrojnë institucionet e pavarura kushtetuese që t'i nënshtrohen kontrollit të pushtetit ekzekutiv lidhur me përcaktimin e ekuivalencave, përkatësisht krijimin e funksioneve pozitive dhe emërtesave në institucionet e tyre në kundërshtim me garancitë përkatëse kushtetuese dhe praktikën gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës”, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, vlerëson se nëse analizohet mirë kjo pikë (377) në kuptim sqarimit të efekteve juridike të aktgjykimit, përmes të njëjtit sqarim arrihet në përfundimin se me pikën VII të dispozitivit të Aktgjykimit, Gjykata Kushtetuese paragrafin 2 të nenit 45 të ligjit të cekur si më lartë, e ka shpallur të pavlefshëm vetëm për Institucionet e Pavarura Kushtetuese.*

Me vetë faktin që sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës është detyruar Kuvendi i Republikës së Kosovës që brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e këtij aktgjykimi të ndryshojë dhe plotësoj paragrafin 2 të nenit 2 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, sipas këtij aktgjykimi, është konstatuar fakti se me rastin e plotësim ndryshimit të këtij paragrafi të qartësohet shprehimisht që institucionet e pavarura kushtetuese rregullojnë dhe zbatojnë procedurat përkatëse të Ligjit të kontestuar, jo vetëm përmes akteve nënligjore, por edhe ligjeve të veçanta në përputhje të plotë me pavarësinë e tyre funksionale, organizative dhe buxhetore të garantuar me Kushtetutë, rrjedhimisht sipas interpretimit apo efekteve të Aktgjykimit për rastin nr. KO79/23 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, pavlefshmëria e paragrafit 2 të nenit 45 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Pagat në Sektorin Publikë nuk mund të ndërlidhet me institucionet e tjera shtetërore, sepse sipas Kolegjit të Këshillit, nëse i referohemi këtij aktgjykimi i njëjti ka lënë në fuqi të gjitha shtojcat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, të cilët janë të zbatueshme përveç për institucionet e pavarura kushtetuese ku është garantuar pavarësia kushtetues e ku këto shtojca aplikohen por në raport me këtë aktgjykim.

Ndërsa sa i përket shtesës SHCK (30) në vlerën prej 31.20€ në baza mujore, që ka të bëjë me shtesën për shërbimin civil, shtesë të cilën nëpunësit civil e kanë realizuar deri në hyrën në fuqi të ligjit të ri të pagave, Kolegji i Këshillit thekson se me dispozitat e aplikuara të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në

Sektorin Publik, në nenin 22 ka përcaktuar llojet e shtesave: “*Shtesat që mund përfëtohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. shtesa e veçantë për të zgjedhurat/it; 1.2. shtesa për kushte tregu të punës; 1.3. shtesa e performancës; 1.4. shtesa për kushte specifike të punës; 1.5. shtesa për punën pa orar të paracaktuar; 1.6. shtesa për vëllimin e punës; 1.7. shtesa për licencë të avancuar për nëpunësen/in e arsimit para universitar; 1.8. shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor; 1.9. shtesa e performancës për krijuesen/in dhe performuesen/in e artit dhe kulturës; 1.10. shtesa funksionale.*”, mirëpo shtesa e shërbimit civil SHCK, më këtë ligj nuk është paraparë, ndërsa me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23 e datës 23.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, është trajtuar kjo çështje dhe sipas dispozitivit si në pikën I është përcaktuar se, citoj: “*TE KONSTATOJE se paragrafi 2 i nenit 2 (Fushëveprimi) dhe paragrafi 2 i nenit 45 (Shfuqizimi) në ndërlidhje me paragrafin 2 te nenit 24 (Shtesa për kushte te tregut te punës), paragrafin 5 te nenit 25 (Shtesa e performancës), paragrafin 4 te nenit 28 (Shtesa për vëllimin e punës) dhe paragrafët 2 dhe 3 te nenit 42 (Përcaktimi i ekuivalencës) te Ligjit nr. 08jL-196 për Pagat ne Sektorin Publik nuk janë ne përputhshmëri me paragrafin 1 te nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe paragrafin 1 te nenit 7 [Vlerat] te Kushtetutës se Republikës se Kosovës*”, nga rrjedh se Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar vetëm për dy (2) lloje të shtesave (Shtesa e performancës dhe Shtesa për vëllimin e punës) që nuk janë ne përputhshmëri me përmbajtjen e caktuar të Kushtetutës se Republikës se Kosovës, nga rrjedh se duke marr për bazë edhe pikë IX të Aktgjykimit në fjalë, citoj: “*“IX. TE KONSTATOJE se deri ne plotësimin dhe ndryshimin e paragrafit 2 te nenit 2 (Fushëveprimi) te Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat ne Sektorin Publik nga Kuvendi i Republikës se Kosovës, paragrafi 3 i nenit 2 (Fushëveprimi), paragrafi 2 i nenit 22 (Shtesat), paragrafi 5 i nenit 24 (Shtesa për kushte te tregut te punës), paragrafi 8 i nenit 25 (Shtesa e performancës), paragrafi 7 i nenit 28 (Shtesa për vëllimin e punës) dhe paragrafi 4 i nenit 42 (Përcaktimi i ekuivalencës) te zbatohen ne përputhje me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim*”, ashtu që, çështja e shtesës në fjalë nuk cenon të drejtën nga marrëdhënia e punës së ankuesve, pasi që shtesa në fjalë SHCK e njohur me Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ka qenë e aplikuar për të gjithë të punësuarit në Shërbimin Civil, dhe si rrjedhojë nuk ka qenë e përcaktuar vetëm për të punësuarit në Komunën e Gjakovës, prandaj si i tillë pretendimi në fjalë i ankuesve nuk mund të trajtohet ne frymën e rregullimit sipas përcaktimeve të aktgjykimit të cekur si më lartë, e për rrjedhojë pretendimi i tyre ankimor nuk është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesve referuar kompensimit shtesës prej 0.5% lidhur më përvojën e punës, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 6 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me të cilin është përcaktuar se: “*6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë*”, dispozita këto të cilat i janë nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, më ç’rast, kjo e fundit, me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, në pikën III të dispozitivit ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ndërsa, në pjesën arsyetues gjegjësisht në pikët 380 dhe 381 ka sqaruar: 380. *Gjykata ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) dhe paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me të drejtën në gëzimin paqësor të pronës dhe barazinë para ligjit. Kjo, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ndër të tjera, sepse (i) zbritja joproporcionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës është në kundërshtim të plotë me parimet kushtetuese, ligjore, parimet relevante ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe përtej cenimit të të drejtave respektive individuale, rezulton edhe në cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe vlerave të Republikës së Kosovës;....ndërsa (v) përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për të gjithë kategorinë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, kufizon të drejtat dhe liritë themelore të tyre, pa asnjë qëllim legjitim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 të Kushtetutës. 381. Thënë këtë, sipas*

sqarimeve të dhëna më sipër ndërlidhur dhe me efektin e Aktgjykimeve të Gjykatës, kjo e fundit (i) nuk do të shfuqizojë paragrafin 6 të nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, ndërsa (ii) do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. 382 Kjo sepse, lidhur me paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar që ndërlidhet me shtesën mbi pagën për përvojën e punës, Ligji i kontestuar në paragrafin 1 të nenit 45 të tij, ka shfuqizuar edhe Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, i cili përfshin nenin 18 (Shtesa mbi pagën për përvojën e punës) sipas të cilit, për çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike, nëpunësit civil sipas këtij ligji i takon e drejta shtesë në pagën bazë prej zero pikë pesë përqind (0,5%). Shpallja e pavlefshme e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar i kombinuar me faktin që Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë shfuqizohet gjithashtu përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar, do të rezultonte në zbrazëti ligjore, përkritazi më të drejtën për shtesa mbi pagën për përvojën e punës. Për pasojë, duke balancuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat dhe liritë themelore, Gjykata do të lë në fuqi paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në periudhën prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, duke i përcaktuar detyrimin Kuvendit, që brenda kësaj periudhe të ndryshojë dhe/ose plotësojë paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi. Në ndryshimin dhe/ose plotësimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Kuvendi duhet të ketë parasysh që efektet e ndryshimit/plotësimit të tij në kontekst të lartësisë së shtesës për përvojën e punës burojnë që nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi”.

Andaj përkritazi me këtë dhe duke marr parasysh faktin se Kuvendi i Republikës së Kosovës, ende nuk ka ndërmarr veprimet konform aktgjykimit të cekur si më lartë, gjegjësisht nuk ka bërë plotësim/ndryshimin e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, atëherë Kolegji i Këshillit, konstaton se pa u bërë ky plotësim ndryshim i ligjit bazik nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, nuk mund të obligoj institucionet që të bëjnë këtë kompensim, pasi që Gjykatat Kushtetuese përmes pikës 382 të Aktgjykimit në fjalë e ka sqaruar që paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, e ka shpallë të pavlefshëm mirëpo e ka lënë në fuqi, e për rrjedhojë në këtë fazë të procedurës nuk është e mundur që pretendimi i ankuesve të konsiderohet si i bazuar, pasi që Kuvendi i Republikës së Kosovës ende nuk e ka bërë plotësimin ndryshimin e ligjit bazik për pagat në sektorin publik.

Prandaj, thënë si më lartë, Kolegji i Këshillit në lidhje me këtë vendimmarrje mori për bazë Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, dhe Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, të datës 23.01.2024, të Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës dhe konstatoi se pretendimet ankimore të ankuesve, duke përfshi edhe kërkesën për shujta, nuk janë të bazuara dhe për rrjedhojë ankesa e ankuesve e parashtruar me datë 07.05.2025 është refuzuar si pabazuar, për ankuesit si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi, ndërsa Vendimi Nr.01-120/02-17033 i datës 03.04.2025, i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës, ka mbetur në fuqi për arsyet e dhënë si në arsyetimin e këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë **nuk është** kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit si në **pikën III të dispozitivit**, sepse:

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, gjegjësisht Kontratave të Punës për kohë të pacaktuara, konstaton se ankuesit si në **pikën III** të dispozitivit të këtij vendimi, janë të punësuar në Komunën e Gjakovës, mirëpo që të njëjtit mbajnë pozita e punës *Zyrtar për Telefoni, dhe Shtëpiak*.

Kolegji i Këshillit, lidhur me statusin e pozitës së ankuesve të cekur si më lartë, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 5 paragrafi 5 i cili përcakton se: 5. *Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës është zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike*”, po ashtu ndërlidhur me

marrëdhënien e punës për nëpunësit teknik dhe mbështetës, Kolegji i Këshillit ju referua nenit 95 Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat Publikë, i cili parasheh se: *1. Punëdhënësi në marrëdhënien e punës të nëpunësve/it teknik dhe mbështetës është institucioni përkatës, përmes udhëheqësve/it më të lartë administrativ të institucionit. 2. Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të ligjit, marrëdhënia e punës ndërmjet institucionit dhe nëpunësve/it teknik dhe mbështetës rregullohet me legjislacionin e punës.*”, dhe për rrjedhojë konstatoi se të lartshënuarit për shkak të pozitave të tyre të punës *Zyrtar për Telefoni, dhe Shtëpiak*, të cilat i mbajnë sipas Kontratave të punës për kohë të pacaktuar, nuk kanë statusin e Nëpunësit të Shërbimit Civil, mirëpo të Nëpunësit Teknik dhe Mbështetës, ndërsa marrëdhënia e tyre e punës i nënshtrohet dispozitave të ligjit të punës dhe legjislacionit të veçantë të fushës

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 27 paragrafi 1, të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrat Publikë, si dhe nenit 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, rithekson faktin se nëpunësit teknik dhe mbështetës fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontestin administrativ në gjykatën kompetente.

Meqenëse nga shkresat e lëndës rezulton se pozita e ankuesit është pozitë e nëpunësit teknik dhe mbështetës dhe nuk ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil, duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që mbi bazë të këtyre pikëpamjeve Kolegji i Këshillit, vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesit si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesve si në pikën III të dispozitivit të këtij vendimi, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesit nuk kanë shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënësi, Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa të Komunës së Gjakovës. Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.845/2025, datë 17/07/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve, Avokatit Esat Sylaj;
- Komunës së Gjakovës (Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore dhe Komisionit të Ankesave të Shërbyesve Publik),si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.